



LIMAK KOSOVO INT'L AIRPORT

AEROPORTI NDËRKOMBËTAR I PRISHTINËS
"ADEM JASHARI"

PROGRAMI NXITËS
2016 - 2018

(27 Mars 2016 - 24 Mars 2018)

NENI 1: SYNIMI

Ky program nxitës ka për qëllim të ofrojë mbështetje për kompanitë ajrore aktuale që i shfrytëzojnë shërbimet e aeroportit dhe për kompanitë e reja ajrore që planifikojnë t'i shfrytëzojnë shërbimet e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" (ANP), me qëllim të rritjes së trafikut (arritjeve/shkuarjeve) dhe efikasitetit operacional në përputhje të plotë me rregulloret përkatëse të Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës dhe Marrëveshjes për Partneritet Publiko Privat të nënshkruar ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Aeroportit Ndërkombëtar Limak Kosovë Sh.A (LKIA).

Produktet dhe kushtet e programit nxitës që do të zbatohen në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" janë përcaktuar nga Programi nxitës i cili i nënshtrohet çmimoreve aktuale që aplikohet për shërbime të aeroportit.

NENI 2: FUSHËVEPRIMI I PROGRAMIT NXITËS

Programi nxitës do të zbatohet duke filluar nga sezona verore 2016 sipas IATA për të gjitha shërbimet e reja direkte duke gjetur zbatim për produktet vijuese nxitëse:

- Nxitja e hapjes së linjave të reja;
- Nxitja e frekuencës/ave të reja;
- Nxitja për vëllim të lartë të trafikut;
- Nxitja për operime me bazë fikse;
- Nxitja për operime në orët jashtë pikut të fluturimeve dhe
- Nxitja me mbështetje financiare për qëllime marketingu.

NENI 3: PËRFITUESIT

Programi nxitës ju drejtohet të gjitha kompanive ajrore komerciale të cilat operojnë apo kanë për qëllim të fillojnë operimet në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" dhe të cilat i përmbushin të gjitha kërkesat dhe kriteret e përshkuara në këtë Program, duke u trajtuar në mënyrë jo-diskriminuese. Të gjitha kompanitë ajrore dhe shfrytëzuesit e Aeroportit mund të përfitojnë nga ky program.

NENI 4: VLEFSHMËRIA

Programi nxitës i LKIA është në fuqi nga 27 Marsi 2016 deri më 24 Mars 2018, përveç nëse njoftohet ndryshe nga LKIA.

Për të qenë pjesë e këtij programi, kompanitë ajrore mund të aplikojnë brenda periudhës kohore: 27 Mars 2016 deri 24 Mars 2018.

NENI 5: PRODUKTET NXITËSE

5.1. NXITJA PËR HAPJE TË LINJAVE TË REJA

Qëllimi i këtij programi nxitës është stimulimi i linjave në vende të cilat aktualisht nuk shërbehen drejtpërdrejt nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari” (ANP), me pjesëmarrjen e LKIA në ndarjen e rrezikut financiar të marrë nga kompanitë ajrore gjatë hapjes të linjave të reja.

Kushtet që duhet të plotësohen janë:

- a) Lidhja ajrore komerciale me një aeroport, që nuk është shërbyer me fluturime direkte në 12 muajt e fundit para aplikimit.
- b) Kompania ajrore që rifillon shërbimin për në destinacionin që e ka ndërpre, do të ketë të drejtën e mbështetjes për këtë produkt vetëm nëse shërbimet ajrore rifillojnë 12 muaj pas ndërprerjes së këtij destinacioni.
- c) Për qëllime të këtij programi, fluturimet duhet të operohen me aeroplan që kanë peshë maksimale të nisjes më shumë se 21.000 kg (njëzet e një mijë kilogram).
- d) Linja duhet të operohet non-stop, p.sh. pa transfere përmes aeroporteve tjera. Linja me ndalesë teknike, ku udhëtarët komercial nuk e lëshojnë apo nuk hipin në aeroplan, konsiderohet si linjë non-stop.
- e) Kompanitë ajrore duhet të operojnë 90% të frekuencave të kërkuara për destinacione të reja dhe t'i operojnë së paku dy (2) vajtje/ardhje në javë.
- f) Fluturimet duhet të operohen së paku në dy sezona të fluturimeve sipas IATA-s pa ndërprerje apo përgjat tërë vitit.

Skema Nxitëse për HAPJEN E LINJAVE TË REJA

Nëse një kompani ajrore hapë një linjë me destinacion të ri në/nga ANP, do të ofrohet zbritje si vijon:

VITI	1	2
ZBRITJA NË TARIFËN E ATERIMIT	100%	100%

5.2. NXITJA PËR FREKUENCA TË REJA

Qëllimi i kësaj nxitjeje është inkurajimi i kompanive ajrore për të planifikuar fluturime të reja në ANP, duke ofruar mbështetjen financiare për çdo fluturim të ri të operuar në Aeroportin Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari".

Frekuencat e reja nga kompanitë ajrore në destinacionet e shërbyera aktualisht apo në destinacionet e reja do të krahasohen sipas sezonave ekuivalente të IATA-s, respektivisht sezona e verës me sezonën e verës dhe sezona e dimrit me sezonën e dimrit apo me periudhën ekuivalente të vitit paraprak.

Kushtet për të përfituar janë:

- a. Kompania ajrore që aplikon për nxitje të frekuencave të reja duhet të shtoj të paktën 1 (një) frekuencë në javë destinacionit ekzistues apo destinacionit të ri, krahasuar me sezonën e njëjtë të IATA-s apo periudhën e njëjtë kohore të vitit paraprak.
- b. Nëse kompania ajrore i zvogëlon frekuencat për ndonjë destinacion të caktuar në vitin paraprak, nuk do të ketë të drejtën e përfitimit të mbështetjes nga programi nxitës nëse këto frekuenca rifillojnë në vitin pasues.
- c. Për qëllime të këtij programi, fluturimet duhet të operohen me aeroplanë që kanë peshë maksimale të nisjes më shumë se 21.000 kg (njëzet e një mijë kilogram).
- d. Linja duhet të operohet non-stop dhe kompania ajrore duhet të fluturoj 90% të fluturimeve sipas orarit të konfirmuar të fluturimeve nga lehtësuesi i orarit të fluturimeve i LKIA.
- e. Fluturimet duhet të operohen së paku në dy sezona me radhë sipas IATA-s apo të jenë shërbime gjatë tërë vitit.

Skema Nxitëse për shtim të FREKUENCAVE TË REJA

Nxitja që do të zbatohet për kompanitë ajrore që sjellin frekuenca të reja është:

VITI	1
ZBRITJA NË TARIFËN E ATERIMIT	100%

5.3. NXITJA PËR VËLLIM TË LARTË TË TRAFIKUT

Qëllimi i këtij produkti është inkurajimi i kompanive ajrore për të rritur vëllimin ekzistues të trafikut të tyre në ANP dhe inkurajimi i kompanive të reja ajrore që të fillojnë me operime në ANP me vëllim të lartë të trafikut, kjo bëhet me anë të ofrimit të mbështetjes së drejtpërdrejt financiare për çdo udhëtar në nisje për vëllimin e trafikut sipas nivele të përcaktuara më poshtë.

Kushtet që duhet të plotësohen janë:

- a) Kompania ajrore që aplikon për përfitim nga nxitja për vëllim të lartë të trafikut duhet të ketë të paktën 25.000 udhëtarë në nisje në total në ANP për vitin kalendarik 2016 ose 2017.
- b) Kompanitë ajrore do të jenë të kualifikuara për këtë produkt vetëm nëse kanë rritje në numrin e pasagjerëve në nisje krahasuar me vitin e kaluar.

Skema e Nxitjes për VËLLIM TË LARTË TË TRAFIKUT

Çdo kompani ajrore që ka më shumë se 25.000 udhëtarë në nisje në ANP gjatë vitit kalendarik 2016 ose 2017, do të ketë mbështetjen financiare vijuese për secilin udhëtar në nisje:

Intervali i Udhëtarëve në Nisje	Përkrahja Financiare që do të Ofrohet
0-25.000 udhëtarë	€ 0,00
25.001-50.000 udhëtarë	€ 0,50
50.001 - 75.000 udhëtarë	€ 1,00
75.001-100.000 udhëtarë	€ 1,50
100.001-200.000 udhëtarë	€ 2,00
200.001-300.000 udhëtarë	€ 3,00
300.001-500.000 udhëtarë	€ 5,00

Shembulli më poshtë jep përlogaritjet nëse një kompani ajrore ka **350.000** pasagjerë në nisje, kështu do të përfitojë nxitjen për vëllim të lartë të trafikut në shumën prej **825.000 EUR**.

12,500 EUR për intervalin 25.001-50.000 udhëtarë (25,000 x 0.5 EUR);
 25.000 EUR për intervalin 50.001-75.000 udhëtarë (25,000 x 1 EUR);
 37.500 EUR për intervalin 75.001-100.000 udhëtarë (25,000 x 1.5 EUR);
 200.000 EUR për intervalin 100.001-200.000 udhëtarë (100,000 x 2 EUR);
 300.000 EUR për intervalin 200.001-300.000 udhëtarë (100,000 x 3 EUR) dhe
 250.000 EUR për 50.000 udhëtarë për intervalin nga 300.001-500.000 udhëtarë (50,000 x 5 EUR).

5.4. NXITJA - MBËSHTETJE E OPERIMEVE ME BAZË FIKSE

Ky program nxitjeje ka për qëllim mbështetjen e kompanive ajrore që do të stacionojnë të paktën 1 (një) aeroplan dhe operojnë fluturime nga/për në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari".

Kushtet që duhet plotësuar janë:

- a) Kjo nxitje është e vlefshme vetëm për kompanitë ajrore që operojnë fluturime të planifikuara (të rregullta) në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari".
- b) Transportuesi duhet të shfrytëzoj PRN si një aeroport bazë për të paktën një nga aeroplanët e kompanisë ajrore në mesin e atyre të llojit dhe kapacitetit të njëjtë që gjendet në aplikacionin për operime me bazë fikse të ofruar nga LKIA. Transportuesi duhet të merr miratimin nga LKIA si operator me bazë fikse dhe të dorëzojë dokumentin e vlefshmërisë për operime ajrore të aeroplanit përkatës.
- c) Aeroplani duhet të shfrytëzoj PRN për qëndrim gjatë natës dhe kompania ajrore duhet t'i filloj operimet e veta në mëngjes nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës.
- d) Për qëllime të këtij programi, fluturimet duhet të operohen nga aeroplanët që kanë peshë maksimale të nisjes më shumë se 21.000 kg (njëzet e një mijë kilogram).
- e) Transportuesi ajror duhet të ketë të paktën 500 rotacione në vit nga PRN me aeroplan të bazuar.
- f) Rritjet në kapacitetin e ulëseve apo ndërrimi i llojit të aeroplanit për arsye të mirëmbajtjes teknike pa zvogëlim të numrit të ulëseve janë të pranueshme.

Skema e Nxitjes së OPERIMEVE ME BAZË FIKSE

VITI	1	2
ZBRITJA PËR TARIFËN E PARKIMIT	100%	100%
ZBRITJA PËR HAPËSIRËN PREJ 20m ² PËR NEVOJA TEKNIKE NË PRN	100%	100%

Shënim:

Produkti vijues i nxitjes: Zbritja në Pakon e Trajtimit në Tokë (GH) prej 20% për fluturimet e operuara gjatë orëve jashtë pikut të fluturimeve në aeroport ofron shumë përfitime për operimet me aeroplanë që e kanë bazën në PRN, sidomos duke i kombinuar disa produkte të nxitjes.

5.5. NXITJA PËR OPERIME JASHTË KOHËS SË PIKUT

Ky produkt i nxitjes ka për qëllim inkurajimin e kompanive ajrore për të shfrytëzuar Aeroportin në orët e lira për Arritje/Shkuarje, dhe synon baraspeshimin në shfrytëzimin e resurseve dhe për të mbajtur nivelin e lartë të shërbimit bazuar në IATA.

Kriteret janë:

- a) Për të aplikuar për nxitjen e mbështetjes së kohës jashtë pikut, duhet të plotësohen të gjitha kushtet e përcaktuara në Pika 5.1 “Nxitja për hapje të linjave të reja” dhe/apo Pika 5.2 “Nxitja e frekuencave të reja”.
- b) Fluturimet e transportuesit ajror që mund të përfitojnë nga kjo nxitje duhet të operohen në intervalet e mëposhtme kohore (kohët janë në UTC):

Për Sezonin Dimëror IATA:

Për D1, D2, dhe D4: Tërë ditën

Për D3, D5 dhe D7: Ndërmjet 19:00 deri 23:59

Për Sezonin Veror IATA:

Për D1: Ndërmjet 08:00 deri 23:59Z

Për D2: Tërë ditën

Për D3: Ndërmjet 14:30 deri 17:00

Për D4: Ndërmjet 08:00 deri 23:59

Për D5: Ndërmjet 11:00 deri 15:30

Për D7: Ndërmjet 14:00 deri 23:59

- c) Të gjitha fluturimet që do të jenë subjekt i kësaj nxitjeje duhet të miratohen para sezonit përkatës sipas IATA-s nga lehtësuesi i orarit të fluturimeve të Aeroportit Ndërkombëtar Limak Kosova.
- d) Fleksibiliteti në shmangien e kohës së arritjes/shkuarjes mund të jetë - 15 minuta deri në STA dhe +15 minuta nga STD. Çdo vonesë e shkaktuar nga performansa operacionale e Aeroportit, moti i keq ose faktorë tjerë të jashtëm nuk llogariten.
- e) Miratimi i aplikacioneve për këtë produkt i nënshtrohet kapacitetit të Aeroportit, të përlllogaritur dhe ndjekur në bazë të nivelit C të shërbimeve sipas IATA-s. Prioriteti aplikohet sipas aplikacioneve të dorëzuara nga kompanitë ajrore.

Skema e Nxitjes për OPERIME JASHTË KOHËS SË PIKUT

ZBRITJA NE PAKON E TRAJTIMIT NË TOKË PËR VAJTJE/ARDHJE:

20%

5.6. NXITJA ME MBËSHTETJE FINANCIARE PËR MARKETING

Ky opsion i programit të nxitjes ka për qëllim inkurajimin e kompanive ajrore që në planet e tyre të shtojnë destinacione ose frekuenca të reja në ANP duke dhënë një shumë financiare për qëllime marketingu.

Kushtet që duhet plotësuar:

Për të aplikuar për nxitjen e mbështetjes financiare për marketing në hapjen e linjave të reja apo frekuencave të reja, duhet të plotësohen të gjitha kushtet e përcaktuara në Nenin 5.1 “Kushtet për hapje të linjave të reja” apo Neni 5.2 “Kushtet për nxitje të frekuencave të reja”.

Skema e Nxitjes MBËSHTETJE FINANCIARE PËR MARKETING

Nëse kompania ajrore hapë linjë ajrore për një destinacion të ri apo shton frekuenca të reja, bazuar në dorëzimin e dokumentacionit mbështetës (kopja e reklamës së realizuar, fatura, dhe kontrata me agjenci mediale, etj.) që dëshmon shpenzimet e marketingut të bëra për promovimin e linjës së re apo frekuencave të reja, do të jepet mbështetje si vijon:

Mbështetje në marketing për hapjen e Linjës së Re:

VITI	1	2
Përkrahje Financiare	30,000 EUR	30,000 EUR

Mbështetja në marketing për Frekuenca të Reja:

VITI	1
Përkrahje Financiare	30,000 EUR

Në rast të disa frekuencave të reja për në destinacionin e njëjtë, shuma e lartpërmendur prej 30,000 EUR mbetet e njëjtë.

NENI 6: KUSHTET E PËRGJITHSHME

1. Për të përfituar nga kjo skemë nxitëse, duhet të lidhet marrëveshje ndërmjet Limak Kosovo Intl. Airport J.S.C. dhe kompanisë ajrore në fjalë. Në këtë marrëveshje, përcaktohen kushtet për rimbursim të ndonjë produkti nxitës.
2. Zgjidhja përfundimtare për rimbursim bëhet sipas marrëveshjes me kompaninë ajrore.
3. Kompania ajrore nuk duhet të ketë ndonjë kërkesë ligjore për të përfunduar një marrëveshje të nxitjes. Megjithatë, për arsye të rregullave të konkurrencës të gjitha kompanitë ajrore do të trajtohen në mënyrë të barabartë në përputhje me dispozitat e parashikuara.
4. Në lidhje me fluturimet të cilat i ndajnë kodet, vetëm operatori transportues është i pranueshëm për të qenë përfitues. Element përcaktues do të jetë numri i fluturimit i kompanisë operuese (jo ai kompanisë së marketingut).
5. LKIA ka të drejtën në moszbatim të ndonjërit prej produkteve nxitëse nëse kompania ajrore nuk i ndjek kushtet e përcaktuara.
6. LKIA ka të drejtën që të merr vendim përfundimtar nëse një kompani ajrore është e pranueshme apo jo për nxitje.
7. LKIA e ruan të drejtën që të rishikon dhe ndryshon skemën e nxitjes, në çdo kohë.
8. Shuma totale e nxitjes që duhet të aplikohet për një kompani ajrore do të përlllogaritet në fund të çdo sezone të IATA-s bazuar në shifrat e realizuara. Për të pasur konfirmimin me kohë, kompanitë ajrore do t'i kryejnë bashkërendimet tremujore që konfirmojnë shifrat e trafikut dhe shumat e papaguara ndaj LKIA.
9. Linjat e reja, frekuencat e shtuara dhe planifikimet e tyre të përfshira në programin operues duhet t'i kenë oraret e tyre të miratuara nga lehtësuesi i orareve të fluturimeve.
10. Formulari i trafikut është dokumenti që mbështet tërë procesin e këtij programi, në veçanti për qëllime të monitorimit të kompanisë ajrore dhe certifikimit të numrit arritjeve/shkuarjeve të realizuara.
11. Ky program nxitës është i ri dhe nëse ka ndonjë paqartësi lidhur me përlllogaritjet, LKIA e ruan të drejtën për të krijuar rregullore shtesë për t'u siguruar që të arrihet qëllimi i përgjithshëm i këtij programi.

12. 90% e frekuencave të planifikuara (siç definohet në kontratë) duhet të jenë të operuara. Zbritjet do të paguhen për fluturimet e humbura/vonuara deri sa përqindja të arrin në 10%.
Mbi 10% e fluturimeve të humbura/vonuara do t'i nënshtrohen anulimit për tërë programin nxitës.

NENI 7: VENDIMI PËRFUNDIMTAR MBI DHËNIEN E STIMULIMIT

Vendimi përfundimtar lidhur me atë nëse një kompani ajrore është e pranueshme për këtë program nxitës është përgjegjësi vetëm e LKIA-s.
LKIA e ruan të drejtën për të refuzuar apo pezulluar, në çdo moment, dhënien e stimulimit në rastet vijuese:

- Kur kompania ajrore nuk siguron pagesë të menjëhershme të ndonjë fature të papaguar ndaj LKIA-s;
- Kur shfrytëzimi i kapacitetit të LKIA-s është në pikën maksimale, atëherë Aeroporti pezullon programin valid nxitës për kompanitë e reja që do të aplikojnë.

Përveç kësaj, LKIA e rezervon të drejtën që në çdo moment të refuzon, suspendon ose ndryshon strukturën e dhënies së nxitjes me njoftim paraprak prej 60 ditësh.

NENI 8: VENDIMI

1. LKIA do të analizoj aplikacionet e dorëzuara dhe do të merr vendimin përfundimtar përbrenda një periudhe prej 15 ditëve të punës pasi që t'i ketë pranuar aplikimet.
2. Për vendimin përfundimtar aplikuesi do të njoftohet përmes postës apo faksit të regjistruar, me konfirmim pranë zyrës qendrore të aplikuesit apo në adresën e cekur në formularin e aplikimit.
3. Nëse miratohet aplikimi dhe plani i tij i fluturimeve, njoftimi sipas Nenit 8.2 do të përfshin një vlerësim fillestar të shumës stimuluese që duhet të jepet.
4. Pranimi i vendimit përfundimtar të LKIA sipas kushteve të këtij Neni dhe formulari i dorëzuar i aplikimit e bëjnë formal pranimin e dyanshëm të kushteve të përcaktuara në këtë program.
5. Marrëveshja (Vendimi) përfundimtar për programin nxitës do të bëhet në formë të kontratës ndërmjet LKIA dhe kompanisë aplikuese.

NENI 9: PAGESA E NXITJES

1. Nxitja e llogaritur dhe e miratuar nën kushtet e këtij programi do të paguhet përmes zbritjes nga shuma e arkëtueshme e LKIA nga kompania ajrore në fund të operimeve gjatë gjithë vitit apo dy sezonave pa ndërprerje sipas IATA, bazuar në një njoftim debiti që duhet që lëshohet nga LKIA.
2. Pagesa e nxitjes gjithmonë do të varet nga konstatimi paraprak, që kompania ajrore është në pajtim me operimet e planifikuara në formularin e aplikimit dhe të miratuar nga LKIA, dhe gjithashtu që së paku 90% nga kohët e dakorduara paraprakisht të miratuara për periudhën në fjalë faktikisht edhe janë shfrytëzuar.

NENI 10: KUSHTET SPECIALE

1. Pas miratimit të aplikimit, palët do të nënshkruajnë marrëveshjen me shkrim e cila i rregullon kushtet specifike të nxitjes dhe që duhet të përfshin së paku informatat vijuese:
 - Kohëzgjatjen e aplikimit;
 - Planin e operatimit;
 - Vlerësimin fillestar të shumës së nxitjes, përlllogaritur në përputhje me planin e propozuar të operatimit;
 - Metodën dhe datën përmbyllëse për dhënien e nxitjes.
2. Cilat do ndryshime të kushteve fillestare të vendosura për dhënien e nxitjes duhet që të ndryshohen me kohë dhe të bëhen pjesë integrale e dokumentit të përmendur në Nenin 8.1.

NENI 11: MBIKQYRJA

Programi do të monitorohet dhe kontrollohet bazuar në planin e detajuar që përvijon një varg operimesh të mbuluara nga nxitja, si dhe në formularët e trafikut të përmendur në Nenin 6.10.